



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:087410

Datë: 29.06.2021

Numri i dokumentit: 01937277

PKR.nr.120/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale kundër të pandehurit V. K. nga f. K. Kamenice, për shkak të vepres penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1, te KPRK-se, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP.I.nr.83/2021, të datës 17.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 29.06.2021, mori dhe shpalli publikisht në të njëjtën ditë dhe gjithashtu perpilojë

A K T G J Y K I M

I pandehuri V. K., nga babai F. dhe nëna M., e lindur D., i lindur më 27.12.1993 në f. K. Kamenice ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesmë, i pa punë, i gjendjes së varfer ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 20.04.2021, rreth orës 09:00 minuta, në f. K. Kamenice, me rastin e kontrollimit të shtëpisë dhe objekteve përcjellse pronë e F. K. (babi i të dyshuarit V. K., i cili gjendej në arrati), me urdhër të Gjykatës UGJK.63/2019, të datës 19.04.2021, i pandehuri në menyrë të paautorizuar e në shkelje të ligjit të zbatueshem për armët ka mbajtur në pronësi dhe ate 1 (nji) pistoletë Valther, Modeli PPK, cal.7.65 mm, me nr. Serik 171721, një karikator, dy fishek 7t.65 mm, dy fishek kalibër 45 Thomson, dhjetë

fishek 9x19mm, 35 fishek 9mm, PA, një kondak i pushkës e të cilat i ka poseduar i pandehuri V., të cilat armë dhe municione i janë konfiskuar gjatë zbatimit të ruder kontrollit të lartëpërmendur nga policia.

- Me këtë ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-ës.
-Andaj, në bazë të nenit 4,38,39,40, 43,69, 73,74 , 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe 365 dhe 450 të KPPRK-ës:

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 350,00 (treqindpesdhjete) euro, të cilën gjobë I pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajë shumën prej nga 20 euro dhe 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

Konfiskohet: 1 (një) pistolette Valther, Modeli PPK, cal.7.65 mm, me nr. Serik 171721, një karikator, dy fisheke 7.65 mm, dy fishek kaliber 45 Thomson,,dhjete fishek 9x19mm, 35 fisheke 9mm, PA, një kondak i pushkes, të cilat do të asgjësohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi , nga njësiti i veçantë i Policisë së Kosovës.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, me dt. 17.06.2021, ka ngritur aktakuzën PP/I nr. 83/2021, ndaj të akuzuarit V. K., për shkak të veprës penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-se**, duke kërkuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave I pandehuri të shpallet fajtor dhe të denohet me dënim meritor sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me datën 29.06.2021, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën I pandehuri e ka pranuar në tersi veprën penale e cila I vihet në barre, duke kërkuar falje për veprën, është penduar dhe ka premtuar se nuk do ta perseris.

Prokurori shtetit Shaban Spahiu është pajtuar me pranimin e fajësive nga ana e të pandehurit.

Pastaj Kryetari I trupit gjykues e ka aprovuar pranimin e fajësive, sepse ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, është i plotë dhe në përputhje të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe ato: Raporti fillestar I incidentit, procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë së të dyshuarit, raporti I kqyrjes në vendin e ngjarjes, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve të datës 20.04.2021, fotodokumentacioni.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka pasur parasysh sjelljen e mirë të të pandehurit në gjykatë, pranimin e fajësive nga ana e të pandehurit pa asnjë hezitim, pendimin për veprën e kryer dhe kërkimin faljen, gjendjen e dobët ekonomike të të pandehurit është i pa punë.

I pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajë shumën prej nga 20 euro, dhe shumën prej nga 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Janë konfiskuar 1 (nji) pistolette Valther, Modeli PPK, cal.7.65 mm, me nr. Serik 171721, një karikator, dy fisheke t.65 mm, dy fishek kaliber 45 Thomson,,dhjetë fishek 9x19mm, 35 fisheke 9mm, PA, një kondak i pushkes, të cilat do të asgjësohen pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nga njësitë e veçanta të Policisë së Kosovës.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti për Krime të Rënda

Me datë 29.06.2021

Procesmbajtësja:
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues:
Naser Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:087410
Datë: 29.06.2021
Numri i dokumentit: 01937277